



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
NJËSIA PËRGJEGJËSE

**SHPLLJE PËR PRANIM TË DREJTPËRDREJTË
NË TRUPËN E NËPUNËSVE CIVILË
TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES (TND)**

Prokuroria e Përgjithshme, shpall konkurrimin për nëpunës civil të kategorisë së lartë drejtuese, për vëndin e punës në pozicionin “**SEKRETAR I PËRGJITHSHËM**”. Proçedura e rekrutimit, përzgjedhjes do të realizohet:

Në zbatim të neneve 27 dhe 29, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Kreut III dhe V të Vendimit nr. 118, datë 05/03/2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 794 datë 29/12/2017, të Këshillit të Ministrave, “Për hapjen e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND edhe për kandidatët e tjerë, jashtë shërbimit civil, dhe për përdorimin e procedurës së pranimit të drejtpërdrejtë në TND për vitin 2018”, Departamenti i Administratës Publike shpall Procedurën e Pranimit të Drejtpërdrejtë në TND.

1. Përshkrimi përgjithësues i punës: (Detyrat)

Sekretari i Përgjithshëm ka këto detyra kryesore:

- a) është nëpunësi autorizues, përgjegjës për menaxhimin financiar, ku përfshihen:
 - a.1 përgatitja, zbatimi, kontrolli i brendshëm financiar, monitorimi, kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i brendshëm;
 - a.2 sigurimi i përdorimit me efikasitet, efektivitet dhe ekonomi të fondeve publike;
 - a.3 përgatitja me drejtoritë përkatëse, e Programit Buxhetor Afatmesëm të institucionit sipas kërkesave të përcaktuara në akte ligjore dhe nënligjore.
- b) bashkërendon punën e strukturave të ndryshme në Prokurorinë e Përgjithshme për zbatimin e politikave të miratuara dhe siguron qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e veprimtarive përkatëse me institucione të tjera;
- c) informon në mënyrë të rregullt Prokurorin e Përgjithshëm në lidhje me veprimtarinë e strukturave të varësisë së tij;
- ç) është përgjegjës për ndjekjen e çështjeve për menaxhimin e burimeve njerëzore të institucionit, veçanërisht për punonjësit, të cilët bëjnë pjesë në shërbimin civil, duke garantuar të drejtat dhe përgjegjësitë e nëpunësve sipas ligjit 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, (i ndryshuar);

- d) ndjek zbatimin e rregullave të etikës dhe të rregullores së brendshme të institucionit për nëpunësit civilë, njofton Prokurorin e Përgjithshëm për rastet e shkeljeve dhe rekomandon masat e nevojshme;
- dh) të përmirësojë standardet në të gjithë shërbimet që ofron institucioni;
- e) përgatit dhe paraqet raporte për veprimtarinë e institucionit për çështje të veçanta brenda detyrave dhe funksioneve të tij.
- f) kryen funksione të tjera të caktuara me ligj ose me urdhër të posaçëm.

2. Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet konkurrimi.

- *Njohurite per Kushtetuten e Republikes se Shqiperise;*
- *Ligjin nr.97/2016, “Per organizimin e funksionimin e Prokurorisë së Përgjithshme;*
- *Ligjin nr.152/2013, “Per nepunesin civil”;*
- *ligji 10296, date 08.07.2010” ndryshuar“ Ligji per menaxhimin financiar e kontrollin”*
- *Kodin e Proçedurave Administrative;*
- *Kodi i Punës*
- *Ligjin nr.9643, date 20.11.2006 i ndryshuar, “Per prokurimet publike”;*
- *Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.1 datë 10.01.2007, “Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike”;*
- *Ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;*
- *Rregulloren e Brendshme te Prokurorisë së Përgjithshme;*

3. Kane të drejtë të konkurrojnë për këto pozicione:

1. Nëpunësit civilë të kategorisë së mesme drejtuese, të cilët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:
 - a.- Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në pozicione të nivelit të mesëm drejtues ose të barazvlefshme me to (kategoria e pagës II-b);
2. Nëpunësit civilë të nivelit të lartë drejtues në institucionet e pavarura, të cilët duhet të plotësojnë kriteret si vijon:
 - a- Të kenë të paktën 1 (një) vit përvojë pune në pozicione të nivelit të lartë drejtues në institucione të pavarura (kategoria e pagës II-a, I-b ose I-a).
 Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët duhet të plotësojnë kriteret minimale si vijon:
 - a.- Të plotësojnë kushtet e përgjithshme të pranimit në shërbimin civil, të përcaktuara në gërmat “a” deri në “dh” të nenin 21 të ligjit nr. 152/2013, të ndryshuar;
 - b.- Të zotërojnë një diplomë të nivelit “Master shkencor”, ose të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë. *Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;*
 - c.- Të kenë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në pozicione të mesme drejtuese ose të barazvlefshme, në:

- institucione të administratës publike;
- institucionet bankare të nivelit të dytë dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- shoqëri tregtare, të cilat, sipas legjislacionit në fuqi, konsiderohen si biznes i madh dhe që, aktualisht, nuk kanë detyrime ndaj shtetit ose nuk janë në proces kundër tij;
- organizata jofitimprurëse, të cilat kanë, të paktën, 5 (pesë) vite që janë krijuar.

Përgjashtimisht, kandidatët nga jashtë shërbimit civil, të cilët kanë punuar dhe/ose punojnë:

- në institucione ndërkombëtare brenda vendit;
- në profesion jashtë vendit;
- pedagogë në institucionet e arsimit të lartë;
- avokatë, noterë apo kontabilistë të miratuar, brenda ose jashtë vendit,

duhet të kenë, të paktën, 5 (pesë) vite përvojë pune, përkatësisht në këto institucione ose në profesion.

4. Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit nr.152/2013, “Per nepunesin civil”, i ndryshuar, si më poshtë:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji.

5. Kërkesat e veçanta të grupit të administrimit të posaçëm janë:

- Te kete perfunduar arsimin e larte dhe te jete diplomuar ne degen ekonomik me diplome te nivelit Master profesional ose te barazvlefshme sipas ligjit per Arsimin e Larte.
- Te kete pervoje pune, jo me pak se 10 vjet.
- Te kete pervoje ne fushen e administrimit, menaxhimit dhe kontrollit finnaciuar.
- Te zoteroje me deshmi metodat e reja te informacionit dhe te kete aftesi shume te mira te perdorimit te PC-se ne programet baze te tij.
- Te kete aftesi te mira komunikimi dhe te punes ne grup.

6. Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Të gjitha grupet e kandidatëve si më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si më poshtë:

- Jetëshkrimin;
- Fotokopje të diplomës;

- c.- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë përvojën në punë);
- ç.- Çdo dokumentacion që vërteton eksperiencën të tjera punësimit brenda ose jashtë vendit, të lëshuar nga punëdhënësi;
- d.- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Kandidatët nga jashtë shërbimit civil, përveç sa më sipër duhet të dorëzojnë dokumentacionin si vijon:

- a.- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- b.- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- c.- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- ç.- Vërtetimin nga institucionet bankare të nivelit të dytë apo shoqëritë tregtare të cilat sipas legjislacionit në fuqi konsiderohen si biznes i madh, në të cilat keni eksperiencën punë, që nuk kanë aktualisht detyrime ndaj shtetit, ose nuk janë në proces kundër tij

Afati i dorëzimit të dokumentave: 30.04.2018

7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Konkurrimi konsiston në:

- 1.- Vlerësimin e jetëshkrimit, që përfshin vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 10 pikë.
- 2.- Testimin me shkrim. Totali i pikëve është 40 pikë.
- 3.- Intervistën e strukturuar me gojë. Totali i pikëve është 50 pikë.

Testimi me shkrim dhe intervista e strukturuar me gojë synojnë vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive të lidhura me fushën sipas përcaktimit në pikën 2 të kësaj shpalljeje.

8. Data e zhvillimit të konkurrimit

Menyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatet për caktimin e datës së zhvillimit të konkurrimit do të bëhet nepermjet adresave të e-mail-eve, me mesazhe në numrin e celularit, në faqen e internetit.

Per me shume informacion per Prokurorinë e Përgjithshme dhe veprimtarinë e saj mund të vizitoni edhe faqen tonë në internet: www.pp.gov.al

Per sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni me numrin telefonik (0694113193), ose në adresën: Prokuroria e Përgjithshme, e Republikës së Shqipërisë, Rruga “Qemal Stafa nr.1, Tirane.

PROKURORIA E PERGJITHSHME